

QARKORE SIGURIE

Numër:	01/2020
Tema:	Operimet me paraglajd dhe deltaplan ne hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës
Për:	Të gjitha entitetet dhe individët të cilët i nënshtrohen Rregullores (AAC) nr. 01/2012 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve

Referenca në legjislacion:

- Nenet 15.1 (h) dhe (j) dhe 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008); dhe
- Rregullore (AAC) nr. 01/2012 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve.

Aplikimi:

Kjo Qarkore Sigurie aplikohet për të gjitha entitetet dhe individët të cilët i nënshtrohen Rregullores (AAC) nr. 01/2012 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve.

Qëllimi:

Kjo Qarkore Sigurie ka për qëllim të mbikëqyrë dhe të siguroj zbatimin në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhrave të aviacionit civil.

Zbatimi:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, duke vepruar në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe në veçanti kushtet e përcaktuara me Rregullore (AAC) nr. 01/2012 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve, obligon të gjitha entitetet dhe individët të cilët i nënshtrohen Rregullores (AAC) nr. 01/2012 zbatimin e masave të parapara me këtë Qarkore Sigurie si vijon:

1. Të gjitha aktivitetet me paraglajd apo deltaplan brenda territorit të Republikës së Kosovës duhet të posedojnë aprovimin përkatës të lëshuar nga AAC-ja, në të

kundërtën të gjitha aktivitetet e evidentuara pa aprovim do të procedohen për masa ndëshkimore sipas Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe Rregullores (AAC) Nr. 02/2019 për Gjobat dhe Masat Administrative të Shqiptuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës.

2. Të gjithë individët të cilët posedojnë licencë të vlefshme të lëshuar nga AAC-ja, të cilët marrin pjesë në aktivitete me paraglajd apo deltaplan pa aprovim nga AAC-ja, do të jenë subjekt i suspendimit ose revokimit të licencës së tyre. Ndaj tyre mund të iniciohet edhe shqiptimi i gjobës sipas masave ndëshkuese sipas Rregullores (AAC) Nr. 02/2019 për Gjobat dhe Masat Administrative të Shqiptuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës.
3. AAC do të kërkojë asistencë nga Policia e Kosovës në identifikim dhe ndalimin e të gjitha aktiviteteve me paraglajd apo deltaplan pa aprovim të lëshuar nga AAC.
4. Të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës të mos lëshojnë asnjë dokument me të cilin përkrahin apo lejojnë shfrytëzimin e vendeve brenda territorit të tyre për aktivitete me paraglajd apo deltaplan pa dëshmi të aprovimit nga AAC.
5. Të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës, të cilat kanë lëshuar dokument të tillë të cekur në pikën d), të pezullojnë të njëjtin deri në lëshim të aprovimit nga AAC.

Hyrja në fuqi:

Kjo Qarkore Sigurie hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 20 gusht 2020.

Bujar Ejupi
Drejtor i Përgjithshëm

